



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 43-të (e jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 07.05.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Egzona Bytyqi, anëtare
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare

- 29. Fehmi Rexhepi, anëtar
- 30. Arben Salihu, anëtar
- 31. Argjend Tasholli, anëtar

Të tjerë prezent:

- 1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
- 2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
- 3. Latif Ramadani DBF
- 4. Anila Reçica, DKRS
- 5. Emina Rexhiq, DPU
- 6. Valon Pacolli, DA
- 7. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së me kërkesë të kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti, kam thirrë seancë të jashtëzakonshme.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit ,Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Propozim vendim për aprovimin e prioritetëve për projektet kapitale për grantin e përfundimit të komunës

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Megjithatë vërejtje as plotësime nuk pati, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi rendin e ditës së propozuar.

I

Propozim vendim për aprovimin e prioritetëve për projektet kapitale për grantin e përfundimit të komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmetit, kryetarit të Komunës së Lipjanit ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të

dhënat nga raporti i cili në vazhdim tha, Këto projekte nuk janë të përfshira në buxhet aktual të vitit 2021, dhe e dyta Aprovimi i këtyre projekteve Komunës së Lipjanit i hap rrugën për aplikim në thirrjet e Grantit të Përformancës Komunale dhe çështja e tretë bashkëfinancimi ku komuna do të hyjë në këto projekte. Dhe e fundit të shuma ku është e shënuar 101,365.95€ do të jetë plus 10 mij euro që do të bëhet, 111,365.95 euro dhe kërkoj nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

Po ashtu i falënderoj punëtorët e administratës për punën po ashtu edhe punëtorët e përformancës .

Në fund partitë politike të cilat janë ngutë me dhanë deklaratë se Komuna e Lipjanit e ka humbë granitin për performancë, është mirë me ju kërkuar falje publikut dhe nuk është mirë me u ngut se ka qenë afati i ankimit dhe tani jemi fitues.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, është e mirë që kemi një shumë të mjeteve financiare për projekte të reja të cilat nuk janë në buxhet të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve. Është dashtë këto projekte me pas një çmim që na me i pas orientimisht çmimet që me pa sa po kushton një projekt. Lipjani ka nevojë edhe për projekte tjera jo veç në ndriçim pasi që ka nevojë për investime në shëndetësi është dashtë një pjesë e mjeteve me shku në shëndetësi. Kam një propozim shtesë që të hiqet asfaltimi i rrugicave në Glllogovc, të zëvendësohet me një projekt tjetër rregullimi i lumit Janjevka. Se edhe në KPF e kam pyet drejtorin e financave ka thënë që nuk ka mjete dhe ai lum ka mbete në gjysmë. Dhe vjen vjeshta shpejt vërshimet prapë mujnë me shkaktuar probleme. Është mirë që po bëhet ndriçimi publik dhe asfaltimi i rrugicave por Lipjani ka edhe projekte tjera. Në Shalë cilat rrugë janë të parapa.

Imri Ahmeti, e dim nevojën e Lumit Janjevka, një pjesë është përfunduar dhe pjesa tjetër në Kuvend është aprovuar mbetet vetëm nënshkrimi i ministrit të financave. Lumi Janjevka kushton shumë dhe do ta na largonte jo vetëm projektin në Glllogovc por edhe disa projekte tjera. Na kemi probleme me lumenj edhe në Smallush dhe shumë fshatra tjera dhe na po presim këto me i akomodua në shikimet tjera. Unë nuk jam me hjek Glllogovcin, ndërsa në Shalë janë të përfshira të gjitha rrugët dhe Krojmiri. Dhe, unë prita që po ju kërkon falje publikut për deklaratat për humbje të grandit për performancë ku jeni ngutë se tani projekti është i fituar.

Lulzim Rrustemi, unë besoj që prioriteti i qytetarëve është mbi të gjitha, ndriçimi publik është i nevojshëm por vërshimet munden me shkaktuar probleme qysh kanë shkaktuar vitin e kaluar. Është mirë të investohet aty ku dëmtohen qytetarët. Të kërkitimi i faljes ajo ka qenë një konferencë e kohës, atëherë nuk është fituar dhe tash është një zhvillim tjetër të cilin e përshëndesim.

Ramiz Qeriqi, dola me i përshëndet këto projekte dhe këto projekte janë shumë të mira, u kanë mirë me pas investime edhe në ujësjellës në kanalizim edhe në shëndetësi. Bile shëndetësi të ketë barna të paktën në kohën pandemisë pasi që janë

nevojë e qytetarëve. Ndërsa sa i përket atyre të PDK-s të pata thanë kryetar edhe një herë mos u merr me ata fëmijët e PDK-s, se nuk ia vlenë,

Imri Ahmeti, une nuk desha me u marr me ta por ata janë dalë me një deklaratë publike qe komuna e ka humbë grandit, ku ka pas 7 ditë afat të ankimimit dhe ne e kemi fituar grandin pas ankesës me argumentet tona dhe kemi pas arsye që e kemi fitu. Dhe nuk është mirë me u ngut. Ata të cilët kanë përfituar nga dëmet e shiut janë paguar në mesin e tyre edhe Luli. Ju duhet me përgëzuar ekzekutivin për këtë grant se kjo është përfituar për qytetarët.

Lulzim Rustemi, rreth lumit Janjevka nuk jetoj vetëm unë por ka shumë shtëpi, nuk jemi paguar ende vetëm janë rekomanduar ato mjete jo vetëm për mu po për qytetarët e Lipjanit. Ndërsa projekteve ju gëzohemi të gjithë.

Ramiz Qeriqi, kam një propozim qe te ndriçimi të përfshihen edhe lapidarët, varrezat e dëshmorëve martirëve, si dhe varrezat e qytetit dhe të fshatrave.

Imri Ahmeti, është problem me i përfshi varrezat në ndriçim publik, por në ato varrezat që janë afër rrugës do të kenë ndriçim publik. Dhe nuk mundemi me i përfshi të gjitha varrezat. Në Krojmir do të përfshihet ndriçimi publik deri të varrezat dhe te shtabi

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura nga Kryetari ku te neni 3 shuma prej 101,365.95€ do të jetë plus 10 mijë euro do të bëhet, 111,365.95 euro dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, 3 abstenime aprovoi

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PRIORITETEVE PËR PROJEKTET KAPITALE PËR GRANTIN E PËRFORMANCËS KOMUNALE

Neni 1

Me këtë Vendim , Kuvendi i Komunës së Lipjanit, APROVON, listën e projekteve kapitale që do të realizohen nga bashkëfinancimi në mesë të Komunës së Lipjanit dhe Grantit të Përformancës Komunale (GPK).

Neni 2

Lista e Projekteve kapitale, përfshin projektet si vijon:

1. Ndriqim publik në Shalë dhe Krojmir,
2. Ndriqimi publik në Ribar të Madh dhe Zllakuqan,
3. Ndriqimi publik në Kraishtë,
4. Ndriqimi publik - faza e dytë në Smallushë,
5. Ndriqimi publik në Janjevë,
6. Ndërtimi i rezervuarit të ujit dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Janjevë,
7. Asfaltimi i rrugicave në Gllogoc,

Neni 3

Shuma e mjeteve nga Granti i Përformancës Komunale (GPK) do të jetë 320,634.00€, (treqind e njëzetmijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër euro), ndërsa shuma e mjeteve nga Komuna e Lipjanit do të jetë 101,365.95€ (njëqind e njëmijë e tretëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro nëntëdhjetë e pesë cent).

Neni 4

Autorizohet, Kryetari i Komunës që duke u bazuar në dispozitat e këtij Vendimi, gjatë aplikimit për fonde të nxjerr Vendime të veçanta për aprovimin e secilit projekt nga lista e projekteve të cekura në nenin 2 të këtij Vendimi. Vendimet e veçanta nxirren në momentin e krijimit të kushteve për aplikim për projektin/projektet përkatëse .

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi